



- Themelohet ministria nr.19;
- 2 alternativat e trasesë së autostradës përfshihen në Planin Hapësinor të Kosovës;
- Fillon përzgjedhja e Sekretarëve të Përgjithshëm të Ministrive, por procesi nuk garanton përzgjedhje jo partiake
- Për 5 muaj, Qeveria arrin të miratoj 17.5% të projektligjeve të përfshira në Strategjinë Legjislative 2011

Hyrje

GAP Monitor për muajin maj 2011 do të ndryshojë lehtësisht përmbajtjen. Projekti i GAP Monitor ka filluar në maj të 2009, me qëllimin e vetëm raportimin për përmbajtjen e vendimeve të Qeverisë së Kosovës dhe zbatimin e tyre vendimeve. Duke raportuar për çdo vendim ekzekutiv, GAP Monitor është munduar që të informojë publikun për përmbajtjen e atyre vendimeve, bazën ligjore, rëndësinë, koston dhe zbatueshmërinë e tyre.

Por nga ky muaj, përmbajtja e GAP Monitor do të përqendrohet në atë se sa vendimet e Qeverisë së Kosovës ndikojnë në përmbushjen e obligimeve që Kosova ka ndërmarrë përmes marrëveshjeve dhe planeve të ndryshme strategjike. Më saktësisht, vendimet e Qeverisë së Kosovës, sa e avancojnë pozitën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian, duke eliminuar sfidat që parashihen në Raportin e Progresit 2010, e të cilat janë përfshirë edhe në Planin e Veprimit për Partneritet Evropian 2011 dhe Planin e Veprimit për 10 prioritetet kyçe të Qeverisë së Kosovës në fushën e integritimit evropian. Gjithashtu, do të analizojmë se sa vendimet e Qeverisë ndikojnë në zbatimin e Strategjisë Legjislative 2011 dhe Planin e Punës së Qeverisë së Kosovës për 2011, si dhe planeve tjera afatgjata të cilat Qeveria e Kosovës do ti miratojë në të ardhmen.

Gjatë këtyre viteve të publikimit të raporteve për vendimet e Qeverisë së Kosovës, kemi vërejtur se planet afatgjata strategjike, ligjore, financiare-ekonomike, etj., mbesin vetëm dokumente në letër dhe vendimet e Qeverisë së Kosovës shpeshherë nuk kanë lidhmëni me planet afatgjata, të miratuara nga vetë Qeveria. Gjatë

këtyre viteve, vendimet e Qeverisë më shumë janë ndikuar nga presionet dhe ngjarjet ad-hoc, se sa që është ndjekur një logjikë e planifikimit afatgjatë. Këtë e dëshmojnë më së mirë planifikimet buxhetore dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve.

Një nga defektet e funksionimit të Qeverisë së Kosovës është edhe mos transparenca. Qeveria e Kosovës pothuajse në çdo mbledhje qeveritare miraton një mori dokumentesh strategjike dhe ligjore. Mirëpo, ato dokumente nuk i shpërndahen medieve dhe shoqërisë civile dhe nuk publikohen në uebfaqet e ministrive apo Zyrës së Kryeministrit. Qasja në këto dokumente paraqet sfidë për ne dhe për organizatat tjera të shoqërisë civile dhe medieve. Andaj, një nga funksionet e GAP Monitor është edhe sigurimi i këtyre dokumenteve dhe publikimi i tyre në portalin e GAP Monitor në internet www.gapmonitor.org.

Në muajin maj 2011, Qeveria e Kosovës ka mbajtur tri mbledhje të rregullta dhe ka marrë 25 vendime. Vendimet e marra të Qeverisë së Kosovës kanë të bëjnë me:

- 2 vendime që kanë të bëjnë me ndryshimin e strukturës organizative të degës së ekzekutivit;
- 8 vendime për miratim të projektligjeve dhe ndryshim të strategjisë legjislative;
- 5 vendime për ndarje të mjeteve financiare;
- 5 vendime për emërimin e zyrtarëve në poste të ndryshme;
- 3 vendime për miratim të planeve, raporteve dhe strategjive;
- 2 vendime tjera;

Përmbajtja:

1. Themelohet ministria nr.19
2. Vendimet e Qeverisë së Kosovës në muajin maj dhe progresi i arritur kundrejt Strategjisë Legjislative 2011
3. 541 mijë Euro për të mbështetur negociatat Kosovë-Serbi
4. Aprovohet Raporti Financiar për Funksionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2010
5. Qeveria shtyn në Kuvend dy alternativat e trasesë së autostradës përmes Planit Hapësinor të Kosovës 2011 – 2020 +
6. Qeveria i propozon Kuvendit emrat për plotësimin e Bordit të Trustit
7. Qeveria i propozon Kuvendit edhe emrat për anëtar të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
8. Përzgjidhen sekretarët e përgjithshëm të dy ministrive
9. Maj 2011: Puna e Qeverisë së Kosovës dhe prioritetet e integritimit evropian
10. Maj 2011: Përmbushja e Planit të Punës së Qeverisë për 2011

Themelohet ministria nr.19

• Ligji për Qeverinë është në procedurë për tu miratuar që nga shkurti i 2008, mirëpo ende asgjë nuk ka lëvizur në këtë drejtim. Mungesa e këtij ligji po shkakton efektin e marrjes së vendimeve të këtilla në mënyrë ad-hoc.



Në mbledhjen e 15-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 18 maj 2011, Qeveria themeloi Ministrinë e Diasporës. Me themelimin e këtij dikasteri të ri qeveritar, kabineti i Kryeministrit Thaçi 2, arrin numrin e portofoleve në 19 sosh. Rëndësia e çdo dikasteri qeveritar është i padiskutueshëm, mirëpo me organizim të kabinetit vështirë se do të këtë efikasitet dhe eficiencë. Kosova do të mund të kishte një kabinet qeveritar më funksional dhe eficient sikur t'i merrte parasysh vërejtjet dhe rekomandimet e projektit të FRI-DOM për rishikimin funksional institucional. (shih qëndrimin e GAP-it të

publikuar në shkurt 2011: <http://instituti-gap.org/repository/docs/GAPqendrim.pdf>).

Kabineti qeveritar i Kosovës, për kokë banori konsiderohet si një ndër kabinetet më të mëdha në vendet e Evropës. Kjo natyrisht që e disfunkcionalizon punën e kësaj të fundit dhe i rrit shpenzimet edhe më shumë. Gjithashtu, është shqetësues fakti që këto aranzhmane brenda kabinetit bëhen në mënyrë ad-hoc, ku nuk vendoset të themelohen dikasteret për shkak të planifikimit institucional mirëpo më përpara për të sistemuar partnerët e koalicionit.

Ministrinë e Diasporës, pas ri-dizajnit të marrëveshjes për koalicionin PDK-AKR, do ta kryesoj AKR-ja, saktësisht Ibrahim Makolli, i cili deri më tani ka mbajtur postin e deputetit në Kuvendin e Kosovës.

Tani, më këtë numër, Qeveria e Kosovës, ka 19 ministri, pritet t'i këtë rreth 32 zëvendësministra, 125 këshilltarë dhe shuma financiare për rrogat e këtij kabinetit pritet të jetë afro 2 milionë euro.

Ka kohë që Ligji për Qeverinë është në procedurë për miratim, mirëpo ende asgjë nuk ka lëvizur në këtë drejtim. Mungesa e këtij ligji po shkakton efektin e marrjes së vendimeve të këtilla në mënyrë ad-hoc.



Vendimet e Qeverisë së Kosovës në muajin maj dhe progresi i arritur kundrejt Strategjisë Legjislative 2011

• Në muajin maj, Qeveria e Kosovës ka marrë 7 vendime që kanë të bëjnë me SL'11. Me 5 vendime të ndryshme janë miratuar 5 projektligje nga SL'11

• Pesë projektligjet e miratuara gjatë muajit maj, ngritin në 26 numrin e projektligjeve të miratuara apo 17.5% të SL'11. Deri në fund të vitet kanë mbetur për tu miratuar edhe 122 projektligje apo 82.5% e strategjisë

• SL'11 duhet të përmbaj edhe një kolonë me datat se kur një projektligj i caktuar do ti dërgohet Kuvendit. Kjo do të bënte më të lehtë punën e Kuvendit dhe planifikim më të mirë.

Për shkak të krizës institucionale dhe zvarritjes në konstituimin e Qeverisë, Strategjia Legjislative 2011 (SL'11) është miratuar tre muaj më vonë se që parashihet me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës. Sipas kësaj Rregulloreje, në dhjetor të çdo viti, Qeveria është e obliguar që të miratoj strategjinë legjislative për vitin pasardhës. SL'11 është miratuar në mars të 2011 dhe në dy muajt e parë nuk është miratuar asnjë projektligj në Qeveri.

Përkundër se Qeveria e Kosovës kishte dhjetë muaj për të zbatuar SL'11, strategjia e këtij viti është një nga strategjitë më të ngarkuara në 4 vitet e fundit. Siç mund të shihet edhe nga ky grafik, përderisa Strategjia Legjislative ka shkuar duke u rritur nga viti në vit, aftësia e Qeverisë për të hartuar dhe miratuar projektligjet ka shkuar duke rënë.

Në muajin maj, Qeveria e Kosovës ka marrë 7 vendime që kanë të bëjnë me SL'11. Me 5 vendime të ndryshme janë miratuar 5 projektligje nga SL'11:

1. Projektligji për Akcizën në Produktet e Duhanit;
2. Projektligji për Përdorimin Civil të Eksplozivëve;
3. Projektligji për Personat e Zhdukur;
4. Projektligji për Ndihmë Shtetërore;
5. Projektligji për Nismat Legjislative;

Përderisa me dy vendime të tjera, Qeveria ka ndryshuar përmbajtjen e SL'11. Në mbled-

hjen e 16 të Qeverisë së Kosovës të mbajtur më 25 maj, Qeveria ka marrë vendim që në SL'11 të përfshihet edhe Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Mërgatën. Ligji për Mërgatën ka hyrë në fuqi në maj të 2010. Ndryshimet në këtë ligj janë parë të nevojshme pas themelimit të Ministrisë për Diasporën. Në ligjin e ri për mërgatën do të përfshihen edhe funksionet e Ministrisë së Diasporës dhe ky ligj tani e tutje do të jetë përgjegjësi e kësaj ministrie.

Po në të njëjtën mbledhje, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që të largojë nga SL'11, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-099 për letërnjoftim. Arsyetimet që janë dhënë për heqjen e këtij projektligji nga SL'11 janë kostoja e lartë e tij, siguria solide e letërnjoftimeve të Republikës së Kosovës dhe siç është thënë në mbledhjen e Qeverisë, lëshimi i letërnjoftimeve të reja nuk është parakusht për fillimin e lëshimit të pasaportave biometrik e as kusht për liberalizim të vizave. Edhe në Raportin e Progresit Kosova 2010 të Komisionit Evropian konstatohet se "letërnjoftimet kanë një standard të lartë të sigurisë".

Mirëpo, edhe përkundër këtyre dy ndryshimeve në SL'11, numri total i projektligjeve në SL'11 mbetet i njëjtë. Pesë projektligjet e miratuara gjatë muajit maj, ngritin në 26 numrin e projektligjeve të miratuara apo 17.5% të SL'11. Deri në fund të vitet kanë mbetur për tu miratuar edhe 122 projektligje

apo 82.5% e strategjisë.

Siç e kemi potencuar edhe më herët në publikimet e GAP Monitor, strategjia legjislative e Qeverisë është pjesë e punës së Kuvendit të Kosovës. Kuvendi harton planin e tij vjetor të punës duke u bazuar në përmbajtjen dhe afatet kohore që parashihen në strategjinë legjislative.

Pikërisht afatet kohore të parapara në SL'11 kanë shkaktuar një keqkuptim në mes të Kuvendit dhe Qeverisë. Datat e përfshira në SL'11 dhe në të gjitha strategjitë legjislative deri më tani, janë datat kur ministrat janë të obliguara që të dërgojnë projektligjet në Zyrën për Shërbime dhe Ndihmë Juridike në Zyrën e Kryeministrit. Sipas procedurave të parapara me Rregulloren e Punës së Qeverisë, projektligjet që arrijnë në Zyrën e Kryeministrit duhet të kalojnë edhe disa faza të vlerësimit financiar dhe përputhshmërisë andaj ky proces merr kohë shtesë nga 30 deri 40 ditë. Siç është potencuar edhe në një tryezë të mbajtur më 28 prill 2011 në Kuvendin e Kosovës, ku Instituti GAP ka prezantuar analizën "Strategjia Legjislative 2008-2011", Plani i Punës së Kuvendit të Kosovës për 2011 nuk përputhet me afatet kohore të SL'11. Një nga rekomandimet e kësaj tryeze ka qenë që SL'11 të përmbaj edhe një kolonë me datat se kur një projektligj i caktuar do ti dërgohet Kuvendit. Kjo do të bënte më të lehtë punën e Kuvendit dhe planifikim më të mirë.



541 mijë Euro për të mbështetur negociatat Kosovë-Serbi

• *Fondi i shpenzimeve të paparashikuara të Qeverisë për vitin 2011 është 3 milion euro. Në pesë mujorin e parë të 2011, Qeveria nga ky fond ka ndarë 1.331.390 euro apo më shumë se 1/3 e fondit.*

• *Edhe pse Qeveria e Kosovës ka autorizuar Ministrinë e Financave që kërkesat për ndarjen e mjeteve deri në 20 mijë euro nga kategoria e "shpenzimeve të paparashikuara" mund të bëhen vetëm me vendim të ministrit (vendimi 04/3, 9 mars 2011), edhe më tutje Qeveria është ajo që vendos edhe për shumat nën 20 mijë euro.*

Qeveria e Kosovës në vazhdimësi i përgjigjet kërkesave për të financuar projekte të pa planifikuara buxhetore, apo për të reaguar në çështjet urgjente.

Në mbledhjen e 14 të mbajtur më 4 maj 2011, me vendimin 05/14 Qeveria e Kosovës ka ndarë 130 mijë euro për kompensimin e shtesave dhe stimulim financiar për punonjësit e Prokurorisë Speciale. Ky institucion ishte themeluar më 26 Shkurt 2010, me vendimin e Qeverisë për të përdorur të gjithë stimuluesit financiar të nevojshëm për këta prokurorë, përfshirë edhe mbrojtjen fizike të tyre. Kryetari i kësaj gjykate që nga janari merr pagë në nivelin e kryeministrit, ndërkaq prokurorët e gjyqtarët në nivel të ministrave. Propozimi për dhënie të fondeve shtesë për të stimuluar punën e Prokurorisë speciale që merret me luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar është aprovuar me sqarimin se kjo Prokurori ballafaqohet me një shkallë të lartë rreziku në natyrën delikate të punës që ata bëjnë. Kjo shumë është paraparë të ndahet nga Buxheti Rezervë i Qeverisë së Kosovës.

Po në të njëjtën mbledhje, me vendimin 06/14, Qeveria e Kosovës ka ndarë 10 mijë euro për mbulimin e aktiviteteve lotuese "Flying for Kosova". "Flying for Kosova" është aktivitet lobues i James Berishës, i cili që nga 2008 me aeroplanin e tij privat fluturon në vendet e Amerikas Latine, Afrikës dhe Azisë për të lobuar për njohjen

e pavarësisë së Kosovës. Z.Berisha ka pasur kontakte edhe me lider të vendeve të ndryshme të botës dhe misioni i tij është pasqyruar në mediet kryesore të vendeve të ndryshme. Aktivitetin më të madh të tij gjatë 2008 dhe 2009 z.Berisha e ka mbuluar me mjetet e tij vetanake. Në 2010, PTK ka hapur një linjë publike ku qytetarët kanë pasur mundësi të kontribuojnë për vazhdimin e misionit lobues të z.Berisha. Ndarja e 10 mijë eurove është ndihma e parë që Qeveria e Kosovës ka dhënë për misionin "Flying for Kosova". Këto mjete janë ndarë nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Për të tretin vit radhazi, Qeveria e Kosovës ka mbështetur financiarisht organizimin e "Berzës së Punësimit Kosova 2011". Me vendimin 07/14, Qeveria e Kosovës i ka lejuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që të transferoj 50 mijë euro në konton e Aleancës Kosovare të Biznesit (AKB). AKB është përgjegjëse për organizimin e berzës. Përkundër që Berza e Punësimit është bërë aktivitet i rregullt, prapë se prapë ky organizim nuk është përfshirë në planifikimin buxhetor të MPMS. Mjetet e ndara do të merren nga kategoria e transferove dhe subvencioneve.

Mbi gjysmë milioni euro janë ndarë për të mbështetur bisedimet Kosovë-Serbi. Në mbledhjen e 16 mbajtur më 15 maj, Qeveria e Kosovës ka ndarë 541 mijë euro për të

mbuluar shpenzime gjertanishme në bisedimet Kosovë-Serbi. Këto mjete janë ndarë nga shpenzimet e paparashikuara të Qeverisë dhe kjo përbën 18% të fondit për shpenzimet e paparashikuara.

Në mbledhjen e 16 të mbajtur më 25 maj, Qeveria e Kosovës ka ndarë 20 mijë euro për ti dalë në ndihmë shtetit të Santa Lucias i cili ndodhet në ishujt e Karaibeve. Në fillim të majit të 2011 Santa Lucia është goditur rëndë nga shirat e rrëmbyeshëm, ku për pasojë ka pasur dëme të mëdha materiale dhe viktima në njerëz. Santa Lucia bën pjesë në ishujt e Karaibeve. Ka një popullatë prej 174 mijë banorësh dhe një GDP prej 1.7 miliard dollarësh. Qeveria e Kosovës edhe vitin e kaluar ka ndihmuar shtetet e goditura nga fatkeqësitë natyrore, siç është rasti i Pakistanit (200 mijë euro) dhe ai i Shqipërisë (50 mijë euro).

Edhe pse Qeveria e Kosovës ka autorizuar Ministrinë e Financave që kërkesat për ndarjen e mjeteve deri në 20 mijë euro nga kategoria e "shpenzimeve të paparashikuara" mund të bëhen vetëm me vendim të ministrit (vendimi 04/3, 9 mars 2011), edhe më tutje Qeveria është ajo që vendos edhe për shumat nën 20 mijë euro.

Fondi i shpenzimeve të paparashikuara të Qeverisë për vitin 2011 është 3 milion euro. Në pesë mujorin e parë të 2011, Qeveria nga ky fond ka ndarë 791.390 euro.



Aprovohet Raporti Financiar për Funkcionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2010

• 64 nga 70 subjekte të sektorit publik kanë themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm

Në mbledhjen e 14-të të Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 4 maj 2011, u miratua Raporti Vjetor për Funkcionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2010.

Ky raport në përgjithësi paraqet zhvillimet në fushën e auditimit të brendshëm në nivelin qendror dhe lokal gjatë vitit 2010.

Duke u bazuar në nenin 8.2 të Ligjit për Auditim të Brendshëm, Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB) për çdo vit kalendarik përgatit dhe ia dërgon Ministrit të Financave Raportin Vjetor në të cilin paraqet aktivitetet e auditimit të brendshëm të realizuara në Qeverinë e Kosovës. Ministri i Financave, pas shqyrtimit të raportit së bashku me komentet e tij e dërgon në

Qeveri, Kuvend të Kosovës dhe në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.

Ky është viti i tretë me radhë për të cilin NJQHAB përgatitë raport të tillë mbi funksionimin e auditimit të brendshëm. Aktivitetet kryesore të NJQHAB për vitin 2010 kanë qenë të përqendruara në përmirësimin e planit vjetor kryesisht në infrastrukturën ligjore dhe në ngritjen e kapaciteteve të auditimit të brendshëm si:

- Nxjerrja e udhëzimit administrativ për komitete të auditimit;
- Ngritja e kapaciteteve të auditorëve të brendshëm;
- Monitorimi dhe vlerësimi i funksionimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik;
- Bashkëpunimi me partnerët;
- Planifikimi i aktiviteteve të NJQHAB për vitin 2011; dhe
- Aktivitetet tjera.

NjQHAB prej 63 njësive të auditimit të brendshëm ka pranuar 61 raporte (95%). Njësitë e Auditimit të Brendshëm të cilat nuk kanë raportuar janë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Komisioni i Pavarur për Media. Zyret e auditorit të brendshëm të këtyre dy institucioneve nuk kanë raportuar për shkak se janë formuar në fund të vitit 2010.

Vlen të përmendet që deri në fund të vitit 2010, 64 nga 70 subjekte të sektorit publik kanë themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm në kuadër të tyre. Përpos Komunës së Shtërpçës, komunat tjera me shumicë serbe ende nuk e kanë themeluar këtë njësi. Komisionet e ndryshme, Zyrat Rregullative, Agjencionet të cilat i raportojnë Kuvendit të Kosovës nuk i plotësojnë kriteret për njësi të pavarura të auditimit të brendshëm.

Qeveria shtyn në Kuvend dy alternativat e trasesë së autostradës përmes Planit Hapësinor të Kosovës 2011 – 2020 +

- *Miratimi i Planit Hapësinor nga Kuvendi i Kosovës, me këtë përmbajtje, do të nënkuptoj pëlqimin e Kuvendit për dy skenarët e trasesë së autostradës.*
- *Përderisa vendimi i Qeverisë miraton Planin Hapësinor 2011 – 2020+, i tërë Plani dhe titulli i Planit janë të emërtuara si Plani hapësinor i Kosovës 2010-2020*


Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 15-të, të mbajtur më 18 maj 2011, miratoi Planin Hapësinor të Kosovës për vitin 2011-2020. I njëjti plan ishte miratuar në Qeveri edhe në muajin korrik të vitit të kaluar, vendim për të cilin kishim raportuar në GAP Monitor (<http://www.gapmonitor.org/?id=2&n=105>). Mirëpo, për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare, Kuvendi i Kosovës nuk arriti të aprovoj këtë plan.

Teksti i planit të miratuar në muajin maj 2011 është i njëjtë me atë të miratuar në korrik të 2010. Në vendimin e Qeverisë

nr.05/15, pika 1, shkruan: Miratohet Planin Hapësinor i Kosovës 2011 – 2020+, kurse teksti i planit përfshin datat 2010-2020+. Ajo që ka ndryshuar, është fjala e ministrit Dardan Gashi në Parathënie, në vend të Parathënies së nënshkruar nga Mahir Yagcilar.

Mirëpo, pika më e rëndësishme e Planit Hapësinor të Kosovës është ajo për trase-në e autostradës Vërmicë – Merdare. Në faqen 180 të Planit hapësinor, ndodhet harta me dy alternativat e trasesë së autostradës. Në mbledhjen e 11 të mbajtur më 27 prill 2011, Kryeministri kishte dhënë

lajmin se është marrë vendim që ti ndryshohet traseja autostradës. Më 28 prill 2011, Instituti GAP kishte raportuar se ndryshimi i trasesë së autostradës bie ndesh me Ligjin për Planifikim Hapësinor (Raporti: <http://www.gapmonitor.org/?id=2&n=359>). Ndërsa, në Planin Hapësinor të Kosovës, i cili pritet ti dërgohet Kuvendit për miratim, përfshihen dy skenarët e trasesë së autostradës Vërmicë-Merdare. Miratimi i Planit Hapësinor nga Kuvendi i Kosovës, me këtë përmbajtje, do të nënkuptoj pëlqimin e Kuvendit për dy skenarët e trasesë së autostradës.



ZHVILLIMET E PARAPARA NË INFRASTRUKTURË

LEGJENDA

- Rrugët magjistrale
 - Rrugët regionale
 - Hekurudhat kryesore
 - Hekurudhat
 - Aeroportet
 - Degatet luftare
 - Antena emetuese
- Zhvillimet e parashikuara**
- Autostrada
 - Alternativat 1 dhe 2 të autostradës
 - Alternativa për dalje në det
 - Alternativa për lidhje me koridore paneuropiane
 - Hekurudha të reja
 - Rrugët me parapsesi për t'u zgjeruar
 - Rrugët që duhet të asfaltohen
 - Rrugë të reja
 - Rrugët me parapsesi për t'u asfaltuar
 - Largpërques (n 400 kV)
 - Plani për ndërtyren e kablrit optik
 - Lidhjet në autostradë
 - Stacione të reja hekurudhore
 - Zhvillim i stacioneve kryesore hekurudhore
 - Akumulacione të reja ujore
 - Termocentrale të reja
 - Hidrocentrale i propozuar
 - Aeroporti i ri i udhëtarëve
 - Vendkalime të reja luftare
 - Rruga unazore
- Koncepti i zhvillimit të gazsjellës në Kosovë**
- Faza I
 - Faza II
 - Faza III
 - Faza IV



Qeveria i propozon Kuvendit emrat për plotësimin e Bordit të Trustit


Që nga marsi i vitit të kaluar, kur ish Kryesuesi i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale z. Besim Beqaj është bërë ministër, ushtrues detyre në këtë pozitë ka qenë z. Ymer Havolli. Vonesa për emërimet në Bordin e Trustit arsye tohen për shkak të zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare dhe procesit deri në fillimin e punimeve të Kuvendit të Kosovës pas zgjedhjeve. Andaj, Qeveria me propozimin e Komisionit për zgjedhjen e anëtarit dhe kryesuesit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovë, emëroj z. Ymer Havolli për kryesues të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ndërsa z. Ejup Qerimi, për anëtar të Bor-

dit. Emrat e propozuar, së bashku me CV-të, i janë përcjellur Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Sipas CV së tij, kuptojmë se, z. Havolli më 2001 ka doktoruar në shkencat ekonomike me disertacion të doktoratës "Menaxhimi i burimeve njerëzore në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme të Kosovës (NVM)". Është njëri nga themeluesit e Institutit Riinvest dhe anëtar i Bordit. Në vitin 2003 ishte zgjedhur si profesor-asistent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës në lëndët: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Etika në Biznes. Në vitin 2007 nga Universiteti i Prishtinës promovohet në

gradën shkencore "Profesor i Asociuar". Kualifikimet kyçe: Menaxhment i Burimeve Njerëzore, Edukim Biznesi dhe Zhvillimi i NVM-ve. Aktualisht është në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin AAB-Riinvest në Prishtinë, në pozitën e Dekanit të Fakultetit Ekonomik dhe gjithashtu është i angazhuar me kohë të caktuar në Institutin Riinvest.

Gjersa, Ejup Qerimi për shumë vite ka qenë anëtar i Odës Ekonomike të Kosovës, ku për dy vite (2005-2007) ka qenë edhe Sekretar i Përgjithshëm i OEK. CV e plotë të z.Qerimi mund ta lexoni në <http://ejupqerimi.blogspot.com/>



Qeveria i propozon Kuvendit edhe emrat për anëtar të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 29 prill 2010. Sipas këtij Ligji, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është agjenci e pavarur, e ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe për mbrojtjen e të dhënave. Anëtarët e saj veprojnë të pavarur në pajtim me këtë ligj dhe nuk pranojnë asnjë udhëzim nga palët e treta. Agjencia në veçanti: jep këshilla organeve publike dhe private për çështjet lidhur me mbrojtjen e

të dhënave; vendos lidhur me ankesat e subjektit të të dhënave; bën inspektime dhe kontrole; informon publikun për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave; dhe promovon dhe përkrah të drejtat themelore për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky Agjencion kryesohet nga Këshilli, i cili përbëhet nga Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror dhe katër Mbikëqyrës Shtetëror. Këshill emërohet nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e Qeverisë së Kosovës për një periudhë pesë

vjeçare me mundësi të emërimit edhe për një mandat.

Andaj, Qeveria për anëtar të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas një viti të miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i propozoj Kuvendit për Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror të Këshillit z. Ruzhdi Jashari, ndërsa për mbikëqyrës Shtetëror propozoi këta kandidat: z. Ramadan Qehaja; z. Mentor Hoxhaj; z. Bekim Demiri; dhe z. Aleksandër Spasiq.



Përzgjidhen sekretarët e përgjithshëm të dy ministrive

- *Ministria e Administratës Publike nuk ka qenë në gjendje që të na thotë emrin e zëvendëskryeministrit i cili është kryesues në Këshillin për Emërime në Pozitat e Larta Drejtuese;*
- *Nuk ka ndonjë kriter për përzgjedhjen e profesorëve të fakultetit dhe anëtarët e shoqërisë civile në Komisionin Vlerësues*
- *Aktet në fuqi, siç janë Ligji për Shërbimin Civil dhe Rregullorja për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese lënë hapësirë për politizim të shërbimit civil;*

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e 15 dhe 16, ka emëruar sekretarët permanent në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Përzgjedhja e sekretarëve të përgjithshëm u bë në bazë të konkursit të shpallur më 1 prill 2011, ku përveç posteve të sekretarëve të përgjithshëm në MD dhe MKRS, janë shpallur të lira edhe pozitat e sekretarëve të përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministrinë e Financave (MF), Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Konkursi ishte i hapur 15 ditë. Pozita e sekretarit të përgjithshëm ushtrohet për një periudhë 3 vjeçare.

Në postin e Sekretarit të Përgjithshëm të MD është emëruar Bedri Bahtiri, i cili deri me rastin e përzgjedhjes ka ushtruar postin e Drejtorit të Zyrës Ligjore në MD. Z.Bahtiri është edhe ligjërues asistent në fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Gjersa në postin e Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS është përzgjedhur Veton Fierzi. z.Fierzi është politikolog i diplomuar dhe nuk ka qenë pjesë e shërbimit civil më parë. Veton Fierzi është anëtar i PDK. Ai ju bashkua PDK-së në prag të zgjedhjeve nacionale të 2010. Ai gjithashtu njihet edhe si shok dhe ish koleg i studimeve i ministrit të MKRS, z.Memli Krasniqi.

Qeveria ka shpallur edhe konkursin e dytë për plotësimin e pozitave të sekretarëve të përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë

e Forcës së Sigurisë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Përderisa në konkursin e mëparshëm, paga mujore ishte 693 euro, në konkursin e dytë, për të njëjtën pozitë, paga mujore është shënuar 909.90 euro.

Pas shpalljes së pavarësisë më 2008 dhe marrjes së kompetencave nga UNMIK, Komisioni për Emërimet e Larta Publike, i cili ishte përgjegjës, ndër të tjera, edhe për të zgjedhur sekretarët permanent të ministrive, u bë jo funksional. KERP nuk mund të funksionalizohet pa nxjerr një ligj të ri për shërbimin civil, duke zëvendësuar Rregulloren e UNMIK. Megjithatë, Ligji për Shërbimin Civil hyri në fuqi tek në janar të 2011, duke bërë që për tri vite të mos funksionoj një mekanizëm adekuat për të emëruar shërbyesit civil në pozitat e larta drejtuese. Përgjatë kësaj periudhe, pjesa më e madhe e posteve të sekretarëve të përgjithshëm të ministrive mbaheshin nga ushtrues detyre, të cilët në të shumtën e rasteve ishin anëtarë të partive në pushtet.

Më 15 shtator të 2010, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të 145 miratoi Rregulloren për procedurat e emërimit në pozitat e larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Sipas kësaj rregulloreje, Kryeministri emëron shtatë anëtar që përbëjnë Këshillin për Emërime në Pozitat e Larta Drejtuese: një nga zëvendëskryeministrat, në rolin e kryesuesit; ministrin përgjegjës për administratë

publike, rolin e zv. kryesues; ministrin përgjegjës për financa, anëtar; një ministër nga radhët e komuniteteve, anëtar dhe tre anëtar të tjerë nga radhët e sekretareve të përgjithshëm apo pozicioneve të barasvlerëshme. Ministria e Administratës Publike nuk ka qenë në gjendje që të na thotë emrin e zëvendëskryeministrit i cili është kryesues i këtij Këshilli.

Ndërsa, Komisioni për Vlerësimin e Kriteve bazuar në këtë rregullore përbehet nga: tre sekretarë të përgjithshëm; një profesor fakulteti nga lëmi përkatës; dhe një anëtar nga shoqëria civile.

Komisionin Vlerësues për përzgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të MD është përbërë nga këta anëtar: Fitim Krasniqi (Sekretar në Zyrën e Kryeministrit), Eshref Shabani (Sekretar në MPMS), Besnik Somani (MAPL), Bajram Ukaj (profesor në Fakultetin Juridik të UP) dhe Behxhet Shala (KMDLNJ).

Kurse, Komisioni Vlerësues për përzgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS është përbërë nga këta anëtar: Skender Gashi (Sekretar në Ministrinë e Infrastrukturës), Besnik Osmani (MAPL), Fitim Krasniqi (ZK), Basri Çapriqi (ligjërues në UP) dhe Mentor Zymberaj (aktor).

Nuk ka ndonjë kriter për përzgjedhjen e profesorëve të fakultetit dhe anëtarët e shoqërisë civile.

Maj 2011: Puna e Qeverisë së Kosovës dhe prioritetet e integritimit evropian

- 87.5% e aktiviteteve të parapara në PVPE 2011 parashihen të kryhen në gjashtë mujorin e dytë të 2011;
- Qeveria nuk ka marrë asnjë vendim konkret për të përmbushur 10 prioritetet kyçe drejt integritimit në BE
- Qeverisë i mbeten vetëm edhe tre muaj për të ndërmarrë hapa konkret dhe për të influencuar pozitivisht Raportin e Progresit 2011

Përveç PVPE 2011, Qeveria e Kosovës në muajin mars ka miratuar edhe "Planin e Veprimit për 10 prioritetet kyçe të Qeverisë së Kosovës në fushën e integritimit evropian". 10 prioritetet kyçe janë:

1. Forcimi i Reformës së Administratës Publike
2. Forcimi i luftës kundër korrupsionit
3. Lufta kundër krimit të organizuar dhe shpëlarjes së parave
4. Menaxhimi efikas dhe efektiv i parasë publike – avancimi i sistemit të prokurimit publik, fuqizimi i mekanizmave për mbledhjen e të hyrave buxhetore, shpenzimi efektiv i buxhetit
5. Forcimi i reformës së gjyqësorit
6. Implementimi i Strategjisë për Liberalizimin e Vizave
7. Negocimi i marrëveshjes tregtare me BE-në dhe zhvillimi i legjislacionit dhe politikave të tregut të brendshëm dhe konkurrencës në harmoni me acquis
8. Mirëmbajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe pjesëmarrja konstruktive në takimet rajonale
9. Infrastruktura – energjia, transporti dhe bujqësia
10. Shëndetësia dhe mjedisi

Në muajin maj dhe në përgjithësi në periudhën janar-maj 2011, nuk është bërë mjaftueshëm drejt realizimit të këtyre 10 pikave. Nuk është ndërmarrë asgjë konkrete drejt forcimit të reformës së administratës publike. Madje veprimet e ndërmarra deri më tani, sidomos në muajin maj, dëmtojnë reformën në administratën publike. Krijimi i ministrisë së 19, asaj të diasporës, rrit numrin e departamenteve në administratën publike dhe nuk i kontribuon eficiencës dhe koordinimit. Njëkohësisht është edhe në kundërshtim me rekomandimet e projektit të FRIDOM. Gjithashtu, zgjedhja e anëtarëve partiak të partisë në pushtet në

postet e sekretarëve të përgjithshëm është gjithashtu një hap prapa në reformën e administratës publike.

Gjithashtu nuk është bërë shumë edhe në luftimin e korrupsionit. Në pesë mujorin e parë të 2011 është marrë vetëm një vendim, që ka të bëjë me ndarjen e 130 mijë eurove për Prokurorinë Speciale të Kosovës. Gjersa nuk ka pasur asnjë veprim konkret për të luftuar krimin e organizuar dhe shpëlarjen e parave.

Prioriteti i 4, që ka të bëjë me menaxhimin efikas dhe efektiv të parasë publike, është një nga prioritetet që gjithashtu nuk është bërë asgjë në përmbushjen e tij, madje është vepruar në drejtim të kundërt. Vendimet e fundit të Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave, kanë vënë në rrezik stabilitetin financiar. Në vitin e kaluar, Qeveria e Kosovës ka pranuar një sugjerim të Komisionit Evropian, që të publikohen raportet e shpenzimeve buxhetore për çdo muaj, mirëpo një gjë e tillë nuk është duke ndodhur.

Nuk është bërë asgjë në arritjen e liberalizimit të vizave dhe marrëveshjes tregtare me BE. Që nga dhjetori i vitit të kaluar, ka skaduar marrëveshja preferenciale në mes BE dhe Kosovës dhe kjo marrëveshje nuk është vazhduar ende, pasi që pengesë po paraqesin 5 vendet që nuk e kanë njohur Kosovën.

Qeverisë së Kosovës i mbeten edhe tre muaj kohë për të ndërmarrë hapa konkret drejt zgjidhjes së sfidave të identifikuara në Raportin e Progresit 2010. Këtë vit, Komisioni Evropian do të mbyll procesin e grumbullimit të të dhënave më 1 shtator 2011, kurse raporti i Progresit 2011 pritet të publikohet në fillim të nëntorit.



Maj 2011: Përmbushja e Planit të Punës së Qeverisë për 2011

- *Ekziston një mos përputhje e afateve kohore të paraqitura në Strategjinë Legjislative dhe Planin e Punës së Qeverisë;*
- *Në 5 mujorin e parë nuk është bërë shumë në drejtim të përmbushjes së objektivave kryesore të përfshira në Planin e Punës*

Qeveria e Kosovës ka bërë praktikë që në fillim të çdo viti të aprovoj Planin e Punës së Qeverisë. Edhe këtë vit, në mbledhjen e 5 të Qeverisë më 16 mars, është miratuar Planin e Punës së Qeverisë 2011.

Planin e Punës së Qeverisë përfshin edhe pikat që janë paraparë me Strategjinë Legjislative të 2011. Andaj, miratimi i 5 projektligjeve në Qeveri, njëkohësisht ndikon edhe në përmbushjen e 5 objektivave të vëna në Planin e Punës së Qeverisë 2011. Nga legjislacioni që parashihej të miratohej me Planin e Punës së Qeverisë gjatë muajit maj, është edhe Projektligji për Qytetin e Prishtinës dhe Plotësim Ndryshimi i Ligjit për Shtetësinë. Këto dy projektligje nuk janë miratuar në Qeveri në muajin maj. Ekziston një mos përputhje në mes të Planit të Punës së Qeverisë dhe Strategjisë Legjislative. Përderisa me Plan të Punës parashihet që Projektligji për Qytetin e Prishtinës të aprovet në maj, me Strategjinë Legjislative parashihet që ky projektligj të arrij në Qeveri tek në fund të muajit shtator. Njëjtë është rasti edhe me Plotësim-ndryshimin e Ligjit për shtetësi, i cili me Plan parashihet që të miratohet në maj, kurse në Strategji parashihet që ky projektligj të arrij në Qeveri në muajin qershor.

Pjesa më e madhe e Planit të Punës së Qeverisë 2011 dhe aktivitetet që parashihen aty, janë aktivitete që implementohen nga ministratë veç e veç dhe jo të gjitha vendimet merren në nivel të Qeverisë, andaj është më i vështirë monitorimi i implemtimit të Planit.

Disa nga aktivitetet kryesore të parapara në Plan dhe për të cilat do të duhej të aproveshin në nivel të Qeverisë dhe për të cilat nuk ka ndodhur ndonjë aktivitet deri më tani janë:

- Zhvillimi i projektit të Hidrocentralit Zhur
- Intensifikimi i kontrollit në pikat kufitare 1 dhe 31
- Inicimi i procedurës zyrtare të aplikimit për anëtarësim në Organizata Botërore e Turizmit (OBT)
- Përmbushja e obligimeve të dala nga marrëveshja me FMN (marrëveshja për hyrjen në program me ç'rast Kosova përfiton shumë prej 108.9 milion euro). Marrëveshja me Bankën Botërore (realizmi i programit SEDPP që do mundësoj marrjen e donacionit prej 60 milion euro) si dhe marrëveshja me Komisionin Evropian (mekanizmi i mbikëqyrjes fiskale që do të mundësoj marrjen e donacioneve të premtuara prej 120 milion eurove për tre vitet e ardhshme)

- Sigurimi i përkrahjes për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Bankën Evropiane Rindërtim dhe Zhvillim
- Zbatimi i rekomandimeve të dala nga Rishikimi funksional (MAP)
- Zbatimi i projektit për e-kabinetin
- Themelimi i Grupit Drejtues për Planifikim të Integruar dokumenteve strategjike në Qeveri

Për të gjitha këto prioritetet, nuk është bërë asgjë në 5 mujorin e parë të zbatimit të Planit të Punës së Qeverisë së Kosovës. Me Plan po ashtu parashihet që çdo tre muaj të vlerësohet zbatimi i Planit të Punës, mirëpo një vlerësim i tillë nuk është bërë në tre mujorin e parë të 2011. Vlerësime tre mujore nuk ka pasu as për planet e punës në 2009 dhe 2010. Në fund të vitit, zakonisht, Qeveria aprovon një raport të punës për 2011.

Të gjitha vendimet e marra gjatë muajit maj:

1 Vendimet nga mbledhja e 14-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 4 maj 2011

- 1.1 Vendimi 01/14, miratohet Projektligji për Akcizën në Produktet e Duhanit;
- 1.2 Vendimi 02/14, miratohet Projektligji për Përdorimin Civil të Eksplozivëve;
- 1.3 Vendimi 03/14, Qeveria propozon 5 kan-

didatët për anëtar të Agjencisë për **Mbrojtjen e të Dhënave Personale**;

1.4 Vendimi 04/14, aprovohet Raporti Financiar për Funkcionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2010;

1.5 Vendimi 05/14, aprovohet kërkesa e Prokurorisë Speciale për kompensimin e shtesave dhe stimulim financiar për punonjësit e Prokurorisë Speciale për vitin 2011 në vlerë prej 130.000.00 euro;

1.6 Vendimi 06/14, aprovohet kërkesa e MPJ për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 10.000.00 euro për misionin lobues “Flying for Kosova”;

1.7 Vendimi 07/14, miratohet kërkesa e MPMS për mbështetjen financiare të projektit “Berza e Punësimit Kosova 2011”.

2. Vendimet nga mbledhja e 15-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 18 maj 2011

2.1 Vendim 02/15, miratohet Platforma Vjetore e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë;

2.2 Vendimi 03/15, miratohet Projektligji për Personat e Zhdukur;

2.3 Vendimi 04/15, miratohet Projektligji për Ndhimë Shtetërore;

2.4 Vendimi 05/15, miratohet Plani Hapësinor i Kosovës 2011 – 2020 +.

2.5 Vendimi 06/15, ndahen mjete financiare në vlerë prej 541.000 euro për mbulimin e shpenzimeve të delegacionit të Kosovës në bisedimet teknike me Republikën e Kosovës dhe Serbisë;

2.6 Vendimi 07/15, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 73 të Ligjit për Miniera e Minerale, i jepet pëlqimi Komunës së Lipjanit për shpalljen e zonës ekonomike;

2.7 Vendimi 08/16, z. Bedri Bahtiri emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;

2.8 Vendimi 09/15, Themelohet Ministria e Diasporës.

3. Vendimet nga mbledhja e 16-të e Qeverisë së Kosovës e mbajtur më 25 maj 2011:

3.1 Vendimi 02/16, miratohet Projektligji për Nismat Legjislative;

3.2 Vendimi 03/16, në Strategjinë Legjislative të 2011 të përfshihet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Diasporën;

3.3 Vendimi 04/16, nga Strategjia Legjislative 2011 ta hiqet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-099 për letërnjoftim;

3.4 Vendimi 05/16, Qeveria emëron z.Ymer Havolli për kryesues dhe z.Ejup Qerimi

anëtar të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;

3.5 Vendimi 06/16, të iniciohen procedurat për zgjedhjen e një anëtari në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale;

3.6 Vendimi 07/16, shpronësim për interes publik, të pronave të paluajtshme të cilat evidentohen në ngastrat kadastrale Nr. 257, 259, 260, 261 dhe 382, në sipërfaqe prej 39.99 ari, të cilët ndodhen në zonën kadastrale të Hajvalisë, për Universitetin Amerikan në Kosovë;

3.7 Vendimi 08/16, Kryeinspektor i punës në Trupën ekzekutive të Inspektoratit të Punës në Kosovë u emërua Z.Basri Rrahmani;

3.8 Vendimi 07/16, z.Veton Fierzi emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

3.9 Vendimi 08/16, Qeveria miratoj edhe propozimin për strukturën e stafit në kabinetin e Zëvendëskryeministrit, në pajtim me Rregulloren nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive;

3.10 Vendimi 10/16, Qeveria e Kosovës, akordoi 20 mijë euro ndihmë për përballimin e pasojave të motit të keq në shtetin Santa Luçia, të cilat do të ndahen nga rezervat e Qeverisë.

gap monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

Rr. Nëna Terezë 41/29
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 38 224 145
monitor@insitutigap.org
www.institutigap.org

"GAP Monitor" është projekt i Institutit për Studime të Avancuara GAP në të cilin monitorohen vendimet e Qeverisë së Kosovës. Projekti i "GAP Monitor" ka filluar në janar të 2009, ku përmes publikimeve të përmuajshme Instituti GAP i ofron publikut informata dhe analiza më të thella për të gjitha vendimet e Qeverisë së Kosovës. Tani, projektit të "GAP Monitor" është shtuar edhe faqja e re në internet, e cila na mundëson interaktivitet më të madh me lexuesit si dhe mundësinë për të publikuar lajme dhe analiza në kohë më të shpejtë.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushëlimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Të gjitha raportet për vendimet e Qeverisë mund të gjenden edhe në portalin e GAP Monitor në internet www.gapmonitor.org

Instituti për Studime të Avancuara GAP
përkrahet nga:



Projekti i GAP Monitor
përkrahet nga:



Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të Institutit GAP dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e donatorëve të këtij projekti.